



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 5 prill 2012, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi – nënkryetar, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Amir Ahmeti, Mufera Şinik dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arben Gashi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Floriana Shala – OSBE, Petrit Hysaj – OSBE, Driton Selmanaj – KDI, Isuf Zejna – KDI, Flutura Kusari – BIRN, Lumniçe Murati – ZPRK, Liridon Dobirdolani dhe Fitore Sadiku – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Behar Selimi - Tha se ftesa për këtë mbledhje ka ardhur si rezultat i përkushtimit tonë për t'i dhënë rrugë procedurale Projektligjit. Kemi pasur keqkuptime edhe me kryetarin. Ai në seancë e ka ftuar mbledhjen. Unë personalisht kam biseduar me kryetarin dhe kam menduar se nuk ka nevojë të mblidhet Komisioni, meqë Projektligji është futur në rend dite me votimin e deputetëve. Meqë Rregullorja nuk është precize, kam menduar që vullneti politik i Kuvendit është suprem karshi komisioneve dhe krejt trupave të tjera të Kuvendit. Ndërkohë ka dalë një interpretim, jo zyrtar, askush nuk na ka dhënë me shkrim, se Komisioni, megjithatë, duhet të mblidhet për ta sjellë raportin për këtë Projektligj. Për këtë kam biseduar me kryetarin. Ai e ka ruajtur pozicionin politik. Andaj në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, 1/3 anëtarëve të Komisionit mund ta ftojë mbledhjen e Komisionit. Ndërkohë jemi informuar se Projektligji është hequr nga rendi i ditës. Për hir të një raporti të mirë që e kemi brenda Komisionit dhe për të qenë edhe shumë profesional, karshi procedurave edhe Rregullores, sugjeroj që sot të mos diskutojmë për Projektligjin, pra ta shtyjmë për më vonë. Gjatë ditës të bëjmë përpjekje që si anëtarë, që jemi më tepër se gjysma, ta kërkojmë mbledhjen me kryetarin në mënyrë të rregullt. Nëse kryetari edhe atëherë nuk na vjen, megjithatë duhet ta bëjmë një raport. Edhe pse personalisht mendoj se s'ka pasur nevojë, sepse që të kalojë Projektligji në rend të ditës, nuk ka nevojë për raporte. Ne, si anëtarë të Komisionit, për të qenë korrekt me procedurat, sugjeroj të mos debatojmë tani për Projektligjin. Është mirë që gjatë ditës, në konsultim me kryetarin, të bëjmë përpjekje ta mbajmë një mbledhje.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi ta autorizojë nënkryetarin që të konsultohet me kryetarin e Komisionit për mbajtjen e një mbledhje të rregullt për shqyrtimin e Projektligjit për bankat, për institucionet mikrofinanciare dhe për institucionet financiare jobankare.

3. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit

Behar Selimi